

Burimet: H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; deklarata Z.Z, FDH-12056.

Ismet (Hazir) Ukaj

(16.09.1976, shqiptar nga Strellci i Epërm/
Gornji Streoc, komuna e Deçanit/Deçani, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Ismeti studionte në Prishtinë/Priština, por për shkak të shqetësimeve konstante që i shkaktonte policia serbe, ai shkoi për të jetuar në Francë. Në datën 15.05.1998, u kthye në Kosovë dhe menjëherë u inkuadrua në UÇK. Menjëherë pas hyrjes në UÇK, ai mori pjesë në luftimet përreth Baballoqit/Babaloc dhe Prilepit/Prilep. Në fshatin e tij të lindjes ka shkuar më **25.05.1998**. Atë ditë, forcat serbe e kishin sulmuar Lybeniqin/Ljubenić. Ismeti dhe i afërmi i tij, Zeqa, ndodheshin në ato çaste në pozicionet e UÇK-së, në vendin e quajtur *Gllavicë/Glavica*. Nga pozicioni i tyre vërejtën se forcat serbe ishin nisur drejt familjeve *Ramosmani* në fshatin **Strellci i Epërm/Gornji Streoc**. E njoftuan familjen që të largohej, ndërkaq ata vet tentuan që t'i bllokoni forcat serbe. Ismeti u plagos gjatë përlshjes së armatosur me forcat serbe. Zeqa e ka çuar menjëherë në spitalin e UÇK-së. Disa ditë më vonë, Ismeti ndërroi jetë. Ai prehet sot në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Strellcin e Epërm/Gornji Streoc.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Dragoljub (Sava) Đukić

(13.03.1964, serb nga Peja, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Pas përfundimit të shkollës së lartë ekonomike, Dragoljubi u punësua në MPB-në e Serbisë, më 1.12.1987. Ka qenë ndihmës komandant i Stacionit Policor në Pejë/Peć. Me gradë ishte rreshter i klasës së parë. U vra në datën **25.09.1998**, gjatë përlshjeve me pjesëtarët e UÇK-së në **Strellcin e Epërm/Gornji Streoc**.

Burimet: SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 26; SMIP, *Teroristički...*, III, 933; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Pripadnici Ministarstva unutra-*

ašnjih poslova - žrtve albanskog terorizma u 1998.godini, na <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078; *Dnevnik od 25. maja do 1. juna*, Ilustrovana politika, nr. 2055, FDH-16958.

Zoje (Shaban Kuqi) Selmonaj

(7.02.1924, shqiptare nga Rastavica, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, gjashtë fëmijë)

Zoja me bashkëshortin Athemin dhe fëmijët e rritur jetonte në fshatin **Rastavicë/Rastavica**. Në datën **25.05.1998**, forcat serbe kanë ndërmarrë një sulm duke hedhur predha minahedhësi mbi fshatin. Zoja rastisi të ishte në oborrin e saj kur një predhë ka rënë dhe ka eksploduar afër saj. E ka humbur jetën në vend. Po atë ditë, bashkëshorti dhe të afërmit e kanë varrosur Zojen prapa shtëpisë familjare. Në muajin gusht të vitit 2003, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet e saj mortore në varrezat lokale.

Burimet: deklarata A.S, FDH-19240; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 176, FDH-23816.

Nexhat (Sadri) Ibërhysaj

(26.11.1970, shqiptar nga Deçani/Deçane, teknik komunikacioni, pjesëtar i UÇK-së)

Nexhati banonte me familjen përballë godinës së Kuvendit Komunal të **Deçanit/Deçane**. Ishte pjesëtar i UÇK-së. Herët në mëngjes, më **26.05.1998**, ai u kthye nga fronti në shtëpi për ta tërhequr familjen nga qyteti, por prindërit nuk donin të largoheshin nga shtëpia. Në atë kohë, numri i madh i shqiptarëve e braktisnin qytetin për shkak të vrasjeve dhe granatimeve. Pas qëndrimit të shkurtër në shtëpi, Nexhati u nis në front. Më të dalë në rrugë, atë e qëllloi snajperi. I ati Sadriu i ka dëgjuar të shtëna dhe ka dalë menjëherë në rrugë. Djali i tij ishte i shtrirë në toke dhe i vdekur. Me ndihmën e të vëllait, Sadriu e ka çuar trupin e të birit në xhaminë e qytetit. Vonë pasdite, Nexhati u varros në varrezat e qytetit të Deçanit/Deçane.

Burimet: deklarata S.I, FDH-31235; deklarata R.I, FDH-12117; deklarata NN, FDH-12104; deklarata A, FDH-12115; deklarata N, FDH-